

SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA

KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës
ŽALBENO VEĆE KAI

GSK-KPA-A-80/2015

Prishtin, 6 shtator 2017

Në çështjen juridike të:

N. D.

Pala ankuese

Askush

Pala Përgjegjëse

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it dhe Isa Kelmendi, anëtarë, duke vendosur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, nr. KPCC/D/A/236/2014 (lënda e regjistruar në AKP me numër KPA13560) i datës 30 Prill 2014, pas shqyrtimit të mbajtur më 6 shtator 2017, mori këtë

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si pabazuar ankesa e N. D. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/A/236/2014, i datës 30 Prill 2014.
2. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/A/236/2014, i datës 30 Prill 2014, për sa i përket lëndës KPA13560.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 27 Shtator 2006, N. D. në tekstin e mëtejme: pala ankuese), ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku kërkon ri-posedimin e ngastrës me nr. 969/5 me sipërfaqe prej 1.39.68 ha, që ndodhet vendin e quajtur Gomilica, në Komunën kadastrale Viti (në tekstin e mëtejme: prona e kërkuar). Kërkesa është regjistruar në AKP me numrin KPA13560.
2. Për ta mbështetur kërkesën e tij, pala ankuese ka dorëzuar dokumentet në vijim:
 - Përshkrimin e listës poseduese Nr.1989 lëshuar nga Sherbimi kadastral e Gjilanit-dega në Viti i dislokuar në Krushevc të Serbisë, ku ngastra kadastrale 969/5 figuron në bashkëpronësi nga ½ të paraqitësit të ankesës dhe të M. S. R;
 - Kopje e planit lëshuar nga Drejtoria Gjeodete Komunale e Vitisë me 10 Tetor 1994 ku ngastra kadastrale-prona e kërkuar evidentohet në emër të Ndermarrjes Shoqerore Bujqesore “Agromorava” e Vitisë;
 - Aktgjykimi P.Nr.210/94 i datës 20 Tetor 1994 lëshuar nga Gjykata Komunale e Vitisë me të cilën anulohet dhenja e pronës s’ë kerkuar shtetit dhe obligohet Ndermarrja shoqerore “Agromorava” t’ia njeh pronësinë paraqitesit të ankesës ;
 - Letërnjoftim i lëshuar me 11 Gusht 1999 nga autoritetet paralele të Serbisë.
3. Më 22 Korrik 2010, AKP-ja ka bërë njoftimin e kërkesës duke vendosur një afishe në pronën e kërkuar. Njoftimi dhe vërtetimi i kërkesës është bërë përmes publikimit në Gazetën për Njoftim të AKP-së nr.2 dhe Zyrën për Pronë të UNHCR-së. Të dy publikimit janë vendosur te dera e hyrjes së Komunës së Vitisë dhe ate të Qarkut në Gjilan. Asnjë palë

përgjegjëse në kërkesë nuk i është drejtuar Sekretarisë Ekzekutive të AKP-së brenda afatit prej 30 ditësh siç përcaktohet me nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 mbi Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronat e Paluajtshme Private, duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079

4. Në bazë të raportit përmbledhës të verifikimit të datës 21 Shkurt 2014 AKP-ja ka konstatuar se dokumentat e bashkangjitura në mbështetje të kërkesës nuk janë gjetur dhe verifikimi ka qenë negativ për aktgjykimin kurse fleta poseduese është gjetur vetëm në arkivat e dislokuara në Serbi .
5. Më 21 gusht 2013, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KKPK) në vendimin e vet të vërtetuar KPCC/D/A/212/2013, e ka refuzuar kërkesën. Në arsyetimin e vendimit (paragrafët 77-78), KKPK-ja ka gjetur se Aktgjykimi nuk është i formës së prerë dhe të dhënat kadastrale në Viti tregojnë se prona e kërkuar figuron në emër të palëve të tjera. Prandaj KKPK-ja ka konstatuar se nuk është deshmuar e drejta pronësore.
6. Më 13 tetor 2014, vendimi i KKPK-së i është dorëzuar palës ankuese. Pala ankuese ka paraqitur ankesë kundër vendimi të KKPK-së më 30 tetor 2014.

Pretendimet e palës ankuese:

7. Pala ankuese pretendon se vendimi i KKPK-së është i paligjshëm dhe jo i saktë sepse përmban shkelje serioze të procesit, zbatim të gabuar të së drejtës materiale, dhe se kërkesa e tij për ri-posedim nuk është vërtetuar plotësisht. Pala ankuese propozon Gjykatës Supreme të aprovi ankesën dhe ta nxjerr aktgjykimin me të cilin i njëjtit palës ankuese të drejtën e shfrytëzimit në rronën e kërkuar. Pala ankuese pretendon se ka sjell dëshmi të mjaftueshme nga arkivat e zhendosur në Serbi dhe se të dhënat kadastrale në Kosovë janë ndryshuar në mënyrë të paligjshme prandaj ai konsideron se ka deshmuar pronësinë mbi pronën e kërkuar.

Arsyetimi ligjor:

8. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve të palës ankuese, në pajtim me nenin 12 dhe 13 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 dhe nenin 194 të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, Gjykata gjeti se Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda periudhës prej 30 ditësh sikurse parashihet me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079
9. Në pajtim me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 pala ankuese ka të drejtë në urdhrin për ri-posedimin e pronës nëse dëshmon pronësinë apo të drejtën e shfrytëzimit të pronës ndaj pronës së kërkuar, dhe që ai nuk ishte në gjendje të ushtrojë të drejtat ndaj pronës për shkak të rrethanave që drejtpërsëdrejti janë të ndërlidhura me ose janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.
10. Pala ankuese e bazon të drejtën pronësore mbi dokumenta të cilat nuk janë gjetur në shërbimet përkatëse në Kosovë por vetëm në arkivat e zhvendosura në Serbi. Të dhënat kadsatrale tregojnë se prona e kërkuar është e evidentuar si pronë shoqerore një pjesëe dhe pjesa tjetër në emra të palëve tjera.
11. Si e tillë, Gjykata Supreme konsideron se pjesa e pronës së kërkuar, nuk është dëshmuar se është pronësi e palës ankuese ne prag te konfliktit dhe nuk ka deshmi të kete qene ne posedim te palës ankuese e të jetë humbur si pasojë e konfliktit. Dhe nuk mund të jetë objekt i nje urdhëri për të marrë të drejtën pronësore ndaj asaj dhe kthimin e posedimit për arsye se pala ankuese nuk ka dëshmuar se prona i ka takuar atij dhe e ka pas ne shfrytëzim para ose gjatë konfliktit apo se e ka humbur si pasojë e konfliktit
12. Gjykata Supreme e konsideronë si të drejtë konstatimin e KKPK-së se Pala ankuese ka deshtuar të dtregoi të drejtën pronësore dhe humbjën e saj menjëhere para ose gjatë konfliktit të vitit 1998-1999 dhe për këtë arsye kërkesa është refuzuar.
13. Përfundimisht Gjykata Supreme e Kosovës konstatoi se vendimi i ankimuar i KKPK-së ishte marrë me vërtetim të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, dhe mbi atë bazë edhe e drejta materiale edhe e drejta procedurale janë zbatuar si duhet. Prandaj, ankesa refuzohet si e pabazuar. Sidoqetjete, kjo nuk e pengon palen qe çeshtjen e saj ta ndjeke ne gjykatën kompetente.

14. Ky Aktgjykim nuk paragjykon te drejtën e Ankuesit për te kërkuar (ose te drejtën ne mjetin juridik) para gjykatës kompetente, nëse ai e sheh te nevojshme.
15. Në bazë të mësipërmes dhe në pajtim me nenin 13.3 nën (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë juridike:

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Beshir Islami, Kryetar i kolegjit

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it

Isa Kelmendi, Gjyqtar

Timi Eljas Torkko, Referent i EULEX-it